



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

TEPELENË

NR 1387.Prot

Tepelenë më, 16.06.2022

V E N D I M

Nr. 48, datë 15.06.2022

PËR

“PJESMARRJËN E BASHKISË TEPELENË NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QELLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, VKM nr 302, datë 11.05.2022 “Për politikatat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, për të negociuar me shoqëritë publike të Ujësjellës Kanalizimeve që aktualisht ushtrojnë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë lidhjen e marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë “Tepelenë” UK, që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jete aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare “Tepelenë” UK për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktore dhe noteriale me qëllim transferimit të veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.

KRYETAR
Elvis Shehu

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Valbona Çela

Miraturar me 8 vota

Vota Pro 8

Vota Kunder 2

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 16.06.2022

